

## NJOFTIM

### Benefitet e integritit të tregjeve të energjisë elektrike

15 – 16 Qershor 2022 Athinë, Greqi

Kryetari i ERE-s z. Petrit Ahmeti, mori pjesë në seminarin e parë “Benefitet e integritit të tregjeve të energjisë elektrike” pjesë e Iniciativës së Bashkimit të tregjeve të energjisë elektrike të vendeve të Evropës Juglindore. Kjo initiative e cila financohet nga [USAID](#), përfshin rregullatorët e Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut, duke përfituar nga eksperiencia dhe sfidat e kolegëve të Greqisë, si në operimin e tregut të një dite më parë nga viti 2020, ashtu dhe në bashkimin e tregjeve me vendet e tjera të EU-së, si Italia dhe Bullgaria. Në fjalën e tij



përsëndetëse z. Ahmeti duke falenderuar [USAID](#) dhe [NARUC](#) për ndihmën e dhënë deri më sot ERE-s dhe për organizimin e këtij seminary, si dhe, koleget e Rregullatorit për Greqinë për mikpritjen, theksoi ndër të tjera rëndësinë e projekteve të cilat lidhen me bashkimin e tregjeve të të tre vendeve, shtrirja me tej me vendet e rajonit si dhe integritit me tregun e

përbashkët të energjisë elektrike në Evropë. Objektivi i kësaj initiative ndër të tjera është të ofrojë asistencë dhe suport në zhvillimin e një tregu konkurrues dhe transparent dhe integrimin e tyre me vendet e BE-së ku kapacitetet e interkonjeksionit optimizohen duke arritur kështu rritjen e mirëqenies ekonomiko - sociale, rritjen e sigurtisë së furnizimit dhe tërheqjen e investimeve në sektor.